



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
BORDI DISIPLINOR**

Nr. (•) i Vendimit

VENDIM

BORDI DISIPLINOR

i përbërë nga :

Jonida Gaba:	Kryetare
Irena Laha:	Anëtar
Merita Prifti:	Anëtar
Elsonida Rama:	Anëtar

në seancat dëgjimore të zhvilluara më datat (•), (•), (•), (•), (•), (•), (•) dhe date (•), mori në shqyrtim kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë, sipas Urdhrit Nr. (•), datë (•) të Ministrit të Drejtësisë “Për nisjen e procedimit disiplinor për noterin (•)”, me të dhënat si më poshtë:

KËRKUES: Ministria e Drejtësisë

DREJTUAR: Bordit Disiplinor, Dhoma Kombëtare e Noterisë

KUNDËR: Subjektit të Procedimit (•), Noter

OBJEKTI: Nisja e procedimit disiplinor për noteren (•); Marrjen e masës disiplinore të përcaktuar në germën dh) të nenit 26 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”.

BAZA LIGJORE: Neni 26, 43-55 i Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar.

BORDI DISIPLINOR

pasi dëgjoji relatimin e Anëtares znj. (•) dhe pasi përfundoi seancën dëgjimore me subjektin e procedimit disiplinor, Noter (•), përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë, znj. (•), specialiste ne Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

A. FAKTET

1. Bordi Disiplinor, Dhoma Kombëtare e Noterisë (në vijim, “Bordi”), ka marrë në dorëzim Urdhrin Nr. (•), datë (•), të Ministrit të Drejtësisë, përcjellë me anë të shkresës Nr. (•) Prot., datë (•), sipas të cilit, në kuptim të germës dh) të nenit 26 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, urdhërohet (citet):

1. Nisjen e procedimit disiplinor për noterin (•).
 2. Dërgimin e raportit të hetimit së bashku me dosjen hetimore Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë.
 3. Bordi Disiplinor, jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së dosjes, të fillojë procedimin disiplinor duke ndjekur procedurën në përputhje me nenin 43 e vijues, të ligjit Nr.110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar.
 4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë për njoftimin e këtij Urdhri noterit (•), Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Degës Vendore të Noterisë (•).
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

2. Po në të njëjtën datë është përcjellë pranë Bordit, edhe dokumenti Nr. (•) Prot., datë (•) “Raport mbi kryerjen e hetimit disiplinor në zyrën noteriale të noterit publik (•)” si dhe dokumentacioni i administruar nga grupi i punës në kuadër të hetimit disiplinor (në vijim, ky raport bashkë me dokumentacionin mbështetës referuar edhe si “**Raporti i Hetimit Disiplinor**”).

3. Nga Raporti i Hetimit Disiplinor rezulton se, në zbatim të Urdhrit nr. 51, datë 03.03.2022 “Për miratimin e programit vjetor të inspektimit të noterëve për vitin 2022” si dhe në zbatim të Urdhrit Nr. (•), datë (•) të Ministrit të Drejtësisë, “Për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm pranë noterit (•)”, grupi i hetimit i caktuar nga Ministri i Drejtësisë ka ushtruar kontroll, më datat (•) dhe (•), pranë zyrës së Noterit (•) për periudhën (•) -(•), me objekt :

- inspektimin e përgjithshëm pranë noterit (•) për të hetuar, verifikuar dhe përcaktuar çdo lloj shkelje që mund të lidhet me ushtrimin e profesionit të noterit;
- verifikimin e zbatimit të ligjit nr. 7829/1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, të ligjit nr, 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë së noterëve, standardeve të sjelljes profesionale si dhe zbatimin e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

4. Kontrolli është kryer në bazë të nenit 6, të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 22, nenin 23, pika 2, nenin 25,29, të Ligjit Nr.110/2018 “Për noterinë”, si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë së noterëve.

5. Në vijim, materiali i grumbulluar i është nënshtruar analizës dhe ballafaqimit të veprimeve noteriale me dispozitat e ligjeve të sipërcituara.

6. Grupi i kontrollit, në përfundim të analizës, ka konstatuar shkelje të rënda të rregullave të parashikuara nga dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë noteriale nga notere (•), që përbëjnë shkak për fillimin e procedimit disiplinor, duke i sugjeruar Ministrit të Drejtësisë masën disiplinore të parashikuar në nenin 26, pika 2, gërma “dh”, të Ligjit Nr. 110, datë 20.12.2018 “Për noterinë”, i ndryshuar.

7. Ministri i Drejtësisë me Urdhrin Nr. (•) datë (•) ka vendosur “Nisjen e procedimit disiplinor për noterin (•); Marrjen e masës disiplinore të përcaktuar në gërmën dh) të nenit 26 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”.

8. Noterja (•) parashtrou në formë shkresore si dhe në seancë dëgjimore përpara Bordit Disiplinor pretendimet e saj, duke parashtruar, ndër të tjera se:

- Urdhri i Ministrit të Drejtësisë Nr. (•) prot., datë (•) “Për nisjen e procedimit disiplinor për noterin (•)” duhet të shpallet i pavlefshëm, pasi nga ana e Ministrisë së Drejtësisë nuk është

zbatuar procedura e parashikuar në aktet ligjore e nënligjore që duhet të ndiqen gjatë kryerjes së një inspektimi të përgjithshëm ndaj noterit.

- Nuk janë respektuar standartet dhe metodologjia gjatë periudhës së inspektimit, në lidhje me njoftimin e noterit përpara kryerjes së inspektimit, sipas procedurës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, lënie e kohës në dispozicion për paraqitjen e dokumentacionit, si dhe dhënien e të drejtës së mbrojtjes gjatë kryerjes së hetimit.
- Nuk është mbajtur plotësuar formulari standard nga ana e inspektorëve, sikurse përcaktuar në urdhër, me qëllim ofrimin e garancisë nga këto të fundit mbi paanshmërinë gjatë kryerjes së detyrës.
- Nuk është respektuar afati kohor i vendosur nga ligji (neni 28) brënda së cilit duhet të kryhet hetimi administrativ.
- Në këto kushte kur është shkelur procedura për një proces të rregullt ligjor, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, kërkohet rrezimi i kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë.

9. Përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë, znj. (•), iu referua Urdhrit Nr. (•) datë (•) të Ministrit të Drejtësisë, përcjellë me anë të shkresës Nr. (•) Prot., datë (•) si dhe dokumenti Nr. (•) prot., datë (•) “Raport për kryerjen e kontrollit në zyrën noteriale të noterit publik (•)”, duke vlerësuar se të gjitha konstatimet e tyre ishin paraqitur nëpërmjet këtyre dokumentave dhe nuk kishte gjë tjetër për të shtuar në lidhje me pretendimet dhe dokumentat shtesë të paraqitura nga noteri (•).

B. VLERËSIMI I BORDIT DISIPLINOR

10. Bordi Disiplinor vlerëson se nuk është në kushtet për të mbyllur procedimin disiplinor, në kuptim të paragrafëve a), b) dhe c) të nenit 44 të Ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar.

11. Seanca disiplinore është mbajtur si seancë publike, në mungesë të kushteve të parashikuara në nenin 47 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë” dhe përbërja e Bordit Disiplinor ka qenë në përputhje me parashikimin e pikës 11, të nenit 42, të të njëjtit ligj dhe në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”.

12. Nga Raporti i Hetimit Disiplinor dhe dosja hetimore përcjellë nga Ministria e Drejtësisë, rezulton se Urdhri Nr. (•), datë (•) i Ministrit të Drejtësisë “Për nisjen e procedimit disiplinor për noterin (•)”, ka dalë në shkelje të afateve të përcaktuara nga Ligji Nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar, konkretisht atij të përcaktuar në nenin 28 të tij.

Ligji Nr. 110, datë 20.12.2018 “Për noterinë”, në pikën 1 të nenit 28 të tij parashikon se:

”... hetimi disiplinor kryhet brenda gjashtë muajve nga marrja e vendimit për fillimin e hetimit. Në përfundim të hetimit, ministri i drejtësisë:

a) i paraqet Bordit Disiplinor raportin e hetimit;

b) jep masën disiplinore sipas neneve 26, pika 5, dhe 27, pika 4, të këtij ligji; ose

c) merr vendim për mbylljen e hetimit...”

13. Nga dokumentacioni i përcjellë nga Ministria e Drejtësisë, rezulton konkretisht se :

- Me Urdhrit Nr. (•), datë (•) “Për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm pranë noterit (•)” është vendosur kryerja e kontrollit pranë zyrës noteriale të noterit. Ky vendim i është njoftuar Noterit në ditën e kontrollit, datë (•). Kontrolli pranë zyrës së Noterit (•) është ushtruar më datat (•) dhe (•).
- Në përfundim të inspektimit, grupi I punës ka përpiluar Raportin “Mbi kryerjen e hetimit disiplinor në zyrën noteriale të noterit publik (•)”, që mban datën (•).
- Afati 6-mujor për përmbylljen e hetimit disiplinor ndaj noterit rezultoi të ketë përfunduar më (•).
- Po kështu, vendimi i Ministrit të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në kuptim të neneve 28 dhe 41 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, është marrë më datë (•), përmes Urdhrit Nr. (•), datë (•) “Për nisjen e procedimit disiplinor për noterin (•)”.

14. Bordi Disiplinor vlerëson se moszbatimi i procedurës së përcaktuar në ligj për nxjerrjen e një akti administrativ, është një element i rëndësishëm, të cilin Bordi duhet ta mbajë domosdoshmërisht në konsideratë në marrjen e vendimeve të tij, duke pasur në vëmendje detyrimin sipas nenit 110 të Kodit të Procedurës Administrative. Paraqitja e një kërkesë apo indicieve fillestare, për një akt me të meta, për të cilat organi publik ka ardhur në dijeni, sjell detyrimin e Bordit për të marrë një hetim tërësor të gjitha fakteve dhe rrethanave të rëndësishme.

15. Bordi Disiplinor pasi analizoi me kujdes faktet, bazën ligjore dhe Urdhrit e Ministrit të Drejtësisë, pasi dëgjoi pretendimet e noterit dhe të përfaqësueses së Ministrisë së Drejtësisë në seancën dëgjimore,

Vlerëson se:

16. Respektimi i procedurës është një ndër elementët që përcakton vlefshmërinë e një akti administrativ dhe shkelja e procedurës mund të kryhet në forma të ndryshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative.

17. Ligji Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar, e lidh kryerjen e hetimit disiplinor me afate dhe procedura e metodologji të mirëpërcaktuara. Në rastin konkret, është tejkaluar afati 6 mujor për kryerjen e hetimit dhe nuk rezultoi të jetë marrë ndonjë vendim për zgjatjen apo pezullimin e afatit të hetimit, sikurse parashikuar nga ligji.

18. Për pasojë, akti administrativ Urdhri Nr. (•), datë (•) i Ministrit të Drejtësisë “Për nisjen e procedimit disiplinor për noterin (•)”, që shënon fillimin e procedimit disiplinor përpara këtij Bordi, bazuar në hetimin disiplinor ndaj noterit (•), ka dalë në shkelje të procedurave të përcaktuara nga ligji, duke mos sjellë asnjë efekt ligjor.

19. Një parim themelor i së drejtës administrative, që buron nga shteti i së drejtës, përcakton se një organ publik duhet t’i përmbahet rregullave për procedurën dhe formën. Edhe nëse nuk i shërben interesit të drejtpërdrejtë të një individi të përfshirë, çdo dispozite mbi procedurën mund të ndikojë përfundimisht në rezultatin substancial të procedurës, pra në përmbajtjen e aktit administrativ. Nga kjo del se çdo mosrespektim i një dispozite të tillë ligjore, ngarkon individin me një barrë dhe nuk korrespondon me pritshmëritë e tij legjitime, për një trajtim pa të meta. Dhe së fundi, çdo rast i mosrespektimit të dispozitave për procedurën ndikon në besimin e përgjithshëm tek funksionaliteti i Bordit, duke rënë ndesh me misionin dhe qëllimin për të cilin ky institucion është ngritur nga legjislatori.

PËR KËTO ARSYE:

Bordi Disiplinor, Dhoma Kombëtare e Noterisë, mbështetur në shkronjën d), të pikës 1 të nenit 51 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë” dhe nenin 11 të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 170 datë 10.06.2020 “Për miratimin e rregullores dhe skemën e kompensimit dhe funksionimin e Bordit Disiplinor”,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj Noterit (*).
2. Ngarkohet Dhoma Kombëtare e Noterisë që, në kuptim të nenit 54 dhe 55 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar, të bëjë publikimin e këtij vendimi dhe ta regjistrojë atë në regjistrin e masave disiplinore.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall më datë (*) në Tiranë.

BORDI DISIPLINOR DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

Jonida Gaba
Kryetare

Irena Laha
Anëtare

Merita Prifti
Anëtare

Elsonida Rama
Anëtare